

"Shërbim seancës plenore



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KUVENDI



## AMENDAMENT

### PËR DISA NDRYSHIME NË PROJEKTLIGJIN “PËR BUXHETIN E VITIT 2025”

Në mbështetje të Nenit 75, pika 4 të Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë, propozojmë,

Në projektligjin “Për Buxhetin e Vitit 2025”, të bëhet ndryshimi, si më poshtë vijon:

#### Neni 1

Në nenin 5, pas paragrafit të dytë shtohen tre paragrafë me këtë përmbajtje:

“Fondi prej 600 milion Lekë do të përdoret për rimbursimin e shpenzimeve për protezat e rikonstruksionit të gjirit dhe paruket për gratë e diagnostikuara dhe në trajtimit mjeksore ndaj kancerit të gjirit. Ky fond detajohet dhe përdoret me vendim të Këshillit të Ministrave.”

“Çelet një fond i posaçëm për blerjen e një pajisje PET Skaner dhe dy pajisje akseleratorë në Qendrën Spitalore Universitare Nënë Tereza, Tiranë. Fondi i posaçëm parashikon të përfshijë edhe shpenzimet për mirëmbatjen në për qëllim funksionimin e pandërprerë pajisjeve. Ky fond detajohet dhe përdoret me vendim të Këshillit të Ministrave.”

## RELACION PËR AMENDAMENTIN

Sëmundetjet nga kanceri që prekin gratë në Shqipëri, po njojin rritje nga viti në vit. Po ashtu sipas të dhënavë nga INSTAT, humbja e jetës nga sëmundshmëri onkologjike është ndër shkaqet kryesore për gratë. Numri i grave me sëmundjet tumoriale është disa herë më i lartë se sa ai që diagnostikohet, kjo për shkak të shumë arsyeve që rrjedhin nga mungesa e akzesimit në çdo komunitet të mamografisë, por dhe barrierave sociale e kulturore ende të shfaqura në shoqërinë tonë.

Ndaj për çdo grua që diagnostifikohet me kancerin e gjirit dhe nis trajimin mjeksore kimioterapinë, përvec rrezikut eminent dhe letal për humbjen e jetës, lindin vështirësi të tjera që lidhen me nevojën për tu ndjerë sërisht grua me dinjitet. Aplikimi i parukes apo dhe aplikimi i një proteze për rikonstrukcionin anatomik të gjirit është një e drejtë për tu ndjerë sërisht grua e femër me dinjitet. Megjithatë kostot e lartë që lidhen me qëndrueshmërinë dhe jetëgjatësinë e materialeve që përdoren për këto dy elemente thelbësore, ia pamundësojmë shumë grave nëpër Shqipëri. Kosotoja për një panuke dhe rikonstruktion me protezë të gjirit, sëbashku arrijnë një vlerë mesatare prej 200,000 lekësh.

Poashtu investimi nga ana e Qeverisë në një pajisje PET Skaner në Qendrën Spitalore Universitare Nënë Tereza, i cili do të shërbejë për një diagozë dhe ndjekje më të saktë të të gjitha grave që luftojnë me kancerin e gjirit dhe jo vetëm. I cilësuar nga të gjithë ekspertët si një nga mjetet diagnostikuese më të mira dhe të avancuara, PET Scan ofrohet në të gjithë botën për të gjithë pacientët e patologjive të ndryshme. PET-CT ofron imazhe shumë të detajuara të të gjitha organeve deri në nivel qelizor dhe është veçanërisht i dobishëm për të diagnostikuar kancerin në fazë të hershme dhe për ndjekje sa më të saktë të pacientëve. Në QSUNT, pacientët nuk e marrin këtë shërbim të nevojshëm dhe ne shpresojmë që Ministria e Shëndetësisë të marrë masat e duhura që së shpejti ky shërbim t'u ofrohet të gjithë pacientëve shqiptarë.

Nga ana tjetër gjëndja aktuale për paraqitet urgjene për nevojën e shtuar me akseleratorë që përdoren për pacientë që kanë nnevojë të marrin rrezatim të diagnostikuar me sëmundjet tumoriale. Aktualisht pranë QSUT gjenden vetëm 2 pajisje akseleratorësh, por për shkak të defekteve të herë pas hershme dhe fluksi i shtuar në përdorim të kësaj pajisje për rrezatim ka krijuar jo pak herë, rradhë të gjatë pritjesh disa ditore për pacientë të cilët kanë nevojë urgjente për këtë trajtim mjeksor. Poashtu kjo bën që në kohë të gjatë pacientët të mos marrin rrezatim, përtëj protokollit të parashikuar.

Nisur nga kjo, sigurimin e një zëri të veçantë për ofrimin e parukes dhe rekonstrukzionin e protezës së gjirit për të gjitha gratë që diagnostikohen me kancer të gjirit, të cilat i nënshtrohen mastektomisë dhe kemioterapisë është përmbytje e një akti social dhe dinjiteti që ka detyrimin shteti t'ua afrojë të gjithë qytetarëve. Shtimi i këtij shërbimi bazë kontribuon drejtëpërdrejtë në zvogëlimin e kostos emocionale të sëmundjes dhe integrim më të shpejtë e dinjitoz të pacientes në jetën e përditshme. Motivimi dhe mbështetja emocionale është një element i rëndësishëm në efektshmërinë e trajtimit të kësaj sëmundje.

Prandaj propozjmë që nenin 5, pas paragrafit 2, të projektligjit për "Buxhetin e Vitit 2025" të shtohen dy paragrafë me këtë përbajtje:

"Fondi prej 600 milion Lekë do të përdoret për rimbursimin e shpenzimeve për protezat e rikonstruktionit të gjirit dhe paruket për gratë e diagnostikuara dhe në trajtimit mjeksore ndaj kancerit të gjirit. Ky fond detajohet dhe përdoret me vendim të Këshillit të Ministrave."

"Çelet një fond i posaçëm për blerjen e një pajisje PET Skaner dhe dy pajisje akseleratorë në Qendrën Spitalore Universitare Nënë Tereza, Tiranë. Fondi i posaçëm parashikon të përfshijë edhe shpenzimet për mirëmbatjen në për qëllim funksionimin e pandërprerë pajisjeve. Ky fond detajohet dhe përdoret me vendim të Këshillit të Ministrave."

**DEPUTETËT**

Zheni Gjergji Of  
Shurato Çupri Gumi

Z. Mëla P. Bely  
Ibla Shani  
Zveter Dreleti  
Finolita Metallo  
Ira Zgjupse  
Eldia Hoxha  
Emelje Shklopj